



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/17/22

Datë: 01.08. 2022

Në bazë të nenit 40.2 germa (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 35 pika 35.1 të Statutit të Komunës së Junikut, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.07.2022, mori vendim për themelimin e Komitetit Konsultativ të Përonave me Aftësi të Kufizuara, në bazë sa u cek më lartë nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS TË ANËTARËVE TË  
KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË  
KUFIZUAR NË KOMUNËN E JUNIKUT

- I. Themelohet Paneli përzgjedhës i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Junikut, në këtë përbërje:
  1. Ermelinda Lolluni LDK - këshilltare nga Kuvendi,
  2. Festina Masloku AAK - këshilltar nga Kuvendi,
  3. Elioza Pepshi LVV - këshilltare nga Kuvendi,
  4. Venera Shala - nga ekzekutivi,
  5. Safete Shehu - nga OJQ-ët.
- II. Kryesuesi i Kuvendit e fton takimin e parë të Panelit, në të cilin takim Paneli e zgjedh kryesuesin, nga radhët e veta.
- III. Detyrë e Panelit përzgjedhës është: zhvillimi i procedurës së intervistimit të kandidatëve që konkurrojnë për anëtarë të Komitetit Konsultativ, sipas kriterëve të përcaktuara me konkurs publik.
- IV. Pas përfundimit të procedurave të intervistimit, Paneli harton raportin dhe i propozon Kuvendit të Komunës për aprovim listën me anëtarë për Komitetin Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Junikut.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit.

VI. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- MAPL ,
- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Të përmendurit në pikën I,
- Arkiva.

